

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministry of Trade and Industry
Ministarstvo Trgovine i Industrije

Komuna e Vushtrisë
Municipality of Vuçitër
Opština Vushtri

Prishtinë, 16/07/2018

Duke u bazuar në nenet 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010), nenin 8 (paragrafi 1.4) dhe Shtojcën 8 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 5 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, si dhe Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, lidhet kjo:

MARRËVESHJE E BASHKËPUNIMIT PËR PROJEKTIN “PARKU INDUSTRIAL NË LUMADH”

Palët nënshkruese

1. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë e përfaqësuar nga Ministri z. Bajram Hasani dhe
2. Komuna e Vushtrisë e përfaqësuar nga Kryetari z. Xhafer Tahiri.

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshje bashkëpunimi është realizimi i projektit të Zonës Ekonomike “Parkut Industrial në Lumadh” si dhe përcaktimi i obligimeve të Ministrisë dhe Komunës për realizimin e projektit në fjalë.

Neni 2 Financimi i projektit

1. Ministria do të financojë Zonën Ekonomike “Parku Industrial në Lumadh” brenda kufijve buxhetor të paraparë për këtë Zonë Ekonomike në Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
2. Vlera e parashikuar e investimit për vitet 2018, 2019 dhe 2020 do të përcaktohet me projektin përfundimtar për investim në “Parkun Industrial në Lumadh”.
3. Vlera e saktë përfundimtare e projektit për vitet 2018, 2019 dhe 2020 për ndërtim të infrastrukturës fizike për “Parkun Industrial në Lumadh” do të përcaktohet në kontratën në mes të Ministrisë dhe operatorit ekonomik të përzgjedhur konform procedurave të legjislacionit në fuqi. Vlera totale e kontratës do të ndahet në tri (3) vite për të cilat Ministria do të bëjë zotimin e mjeteve konform kufijve buxhetor të paraparë për këtë Zonë Ekonomike në Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
4. Në pamundësi të realizimit të punimeve konform vlerës financiare të paraparë ndër vite, vlera e mbetur e parealizuar e vitit paraprak, nëse ka, nuk do të planifikohet nga ana e Ministrisë me rastin e ndarjes dhe zotimit të mjeteve për vitin vijues, përveç me vendim tjetër të veçantë të Ministrisë.

Neni 3 Përgjegjësitë e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë

1. Ministria udhëheqë dhe realizon të gjitha procedurat e prokurimit për hartimin apo revidimin e projektit të zonës ekonomike.
2. Ministria udhëheqë dhe realizon të gjitha procedurat e prokurimit dhe do të nënshkruajë kontratën trevjeçare në pajtim me legjislacionin përkatës të prokurimit publik dhe menaxhimit të financave publike. Mjetet e parapara në Nenin 2 do të ndahen nga Ministria vetëm për shpenzimet e realizimit të kontratës konform kufijve buxhetor të paraparë për këtë Zonë Ekonomike në Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës, konkretisht për punët e aprovuara nga mbikëqyrësi i projektit dhe menaxheri i projektit të përcaktuar konform vendimit të Ministrisë.
3. Pagesat për vitet 2018, 2019 dhe 2020 do të i bëhen operatorit ekonomik konform kontratës.
4. Pagesat bëhet vetëm për aktivitetet e përfunduara në bazë të situacioneve të paraqitura nga operatori ekonomik të vërtetuara nga mbikëqyrësi i projektit dhe menaxheri i projektit të përcaktuar konform vendimit të Ministrisë.

5. Pagesat bëhen vetëm për aktivitetet e zonës ekonomike në fjalë dhe jo për ndonjë aktivitet tjetër.
6. Finalizimi i kontratës në mes të Ministrisë dhe operatorit ekonomik do të bazohet në raportin e procesit të vlerësimit përfundimtar tekniko-financiar (pranimi teknik).
7. Ministria më kërkesë të Komunës dhe në raste tjera, kur kjo është e domosdoshme do të i dërgoj Komunës këto të dhëna:
 - 7.1 Kopjet e kontratës;
 - 7.2 Kopjet e raporteve të menaxhimit dhe mbikëqyrjes së punimeve;
 - 7.3 Detajet e pagesave të bëra sipas kontratës; dhe
 - 7.4 Dokumente dhe raporte tjera sipas nevojës.

Neni 4 Përgjegjësitë e Komunës së Vushtrrisë

1. Komuna me vendim do të përcaktoj zyrtarin përgjegjës për koordinim me Ministrinë me qëllim të mbarëvajtjes së punimeve në teren.
2. Marrëdhëniet pronësore-juridike dhe sigurimi i punishtes janë përgjegjësi e Komunës.
3. Bizneset e vendosura në Zonën Ekonomike “Parkut Industrial në Lumadh” do të paguajnë qiranë konform vendimit të Komunës, e cila do të faturohet nga ana e Komunës, duke marrur për bazë rekomandimin e Bordit.

Neni 5 Përgjegjësitë dhe zotimet e përbashkëta

1. Ministria ka autoritetin dhe përgjegjësin të lidh kontratën me kompaninë e cila është vlerësuar si më e përgjegjshme teknikisht dhe financiarisht dhe të përcaktoj menaxherin dhe mbikëqyrësin i cili do të menaxhoj dhe mbikëqyrë realizimin e projektit.
2. Menaxheri dhe mbikëqyrësi i përcaktuar nga Ministria për monitorim të punimeve kanë kompetenca të plota për ndërhyrje në rast që konstatojnë së punimet nuk janë në përputhshmëri me kontratën.
3. Mbikëqyrësi dhe menaxheri do t'i raportojnë Autoritetit nga i cili është përcaktuar.
4. Me anë të vendimit të nxjerrë nga Ministria do të themelohet Bordi Mbikëqyrës (Bordi) prej shtatë (7) anëtarësh, pesë (5) nga Ministria dhe dy (2) nga Komuna. Detyrat dhe përgjegjësitë e Bordit janë të vlerësoj aplikimet e bizneseve, të bëjë selektimin e tyre konform shpalljes publike dhe të rekomandoj Komunën e Vushtrrisë që të ndajë parcelat për bizneset përfituese. Njëherit Bordi do të i rekomandoj Komunës çmimoren e qirasë për shfrytëzimin e parcelave në “Parkun Industrial në Lumadh”. Detyra dhe përgjegjësi tjera të Bordit do të përcaktohen me rregullore të punës të nxjerrur nga Bordi.

Neni 6 Shqetësimet shtesë të ngritura nga palët

1. Palët ndajnë shqetësimin e përbashkët lidhur me keqpërdorimet e mundshme, të cilat rrezikojnë udhëheqjen e mirë dhe përdorimin e duhur të burimeve që nevojiten për zhvillimin dhe konkurrencën e drejtë dhe të hapur të bazuar në çmim dhe cilësi.
2. Palët deklarohen se për çfarëdo keqpërdorimi të mundshëm do të bëjnë njoftim zyrtar.

Neni 7 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Palët do të bëjnë përpjekje për t'i zgjidhur mosmarrëveshjet eventuale që mund të kenë ndërmjet veti, përmes mirëbesimit ose negociatave miqësore. Ndonjë konflikt apo kërkesë e cila vjen si interpretim i marrëveshjes duke përfshirë esencën e saj, validitetin apo përfundimin e saj duhet të zgjidhet nga gjykata kompetente.

Neni 8 **Amendamentet**

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me shkrim me pëlqimin e dyanshëm të nënshkruesve të marrëveshjes.

Neni 9 **Përfundimi**

Palët mund të shkëpusin marrëveshjen me akt të njëanshëm duke dhënë 30 (tridhjetë) ditë afat me njoftim paraprak (arsyetim), në formë të shkruar palës tjetër.


Neni 10 **Kopjet e Marrëveshjes**

Kjo marrëveshje është hartuar në katër (4) kopje origjinale, ku secila palë nënshkruese merr nga dy (2) kopje.

Neni 11 **Hyrja në fuqi**

Kjo Marrëveshje hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.

Bajram Hasani
Ministër i Tregtisë dhe Industrisë



[Handwritten signature of Bajram Hasani]

Xhafer Tahiri
Kryetar i Komunës së Vushtrrisë



[Handwritten signature of Xhafer Tahiri]